



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I KOMUNËS - GJAKOVË
SKUPŠTINA OPŠTINE DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



KOMUNA E GJAKOVËS

Kuvendi i Komunës

01 Nr. _____/2008

Datë 02.06.2008

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 02.06.2008, pas diskutimeve lidhur me pikën e VII – të, të rendit të ditës: Shqyrtimi i kërkesës së qytetarëve : z.Ismet Ahmeti, z.Zeqir Haxhija dhe z.Dervish Tahiri, për riurbanizimin e zonës së ngushtë në ngastrat kadastrale me numra: 700/10,701/2,704/1,705/1,705/2 dhe 701/1 si dhe dhënia e lejes së ndërtimit për objektin kolektiv të banimit me etazhitet B+P+8+NK në ngastrat kadastrale me numra: 700/10,701/2,704/1,705/1 dhe 705/2, e miratoi këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet kërkesa e qytetarëve: z. Ismet Ahmeti, z. Zeqir Haxhija dhe z. Dervish Tahiri, për riurbanizimin e zonës së ngushtë e kufizuar me këto ngastra me numra: 700/10, 701/2, 704/1, 705/1, 705/2 dhe 701/1, si dhe dhënia e lejes së ndërtimit për objektin kolektiv të banimit me etazhitet B+P+8+NK në ngastrat kadastrale me numra: 700/10, 701/2, 704/1, 705/1 dhe 705/2.

II. Objekti i ndërtuar pa leje ndërtimi në ngastrat me numër: 700/10, 701/2, 704/1, 705/1 dhe 705/2, të legalizohet dhe inkorporohet në revidim të zgjidhjes.

III. Obligohet Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit të inicion procedurat për realizimin e obligimeve që dalin nga pika I dhe II e këtij vendimi.

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

A r s y e t i m

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 02.06.2008, të cilën e kryesoi Kryetari i Komunës dr. Pal Lekaj, pas diskutimeve lidhur me pikën e VII-të, të rendit të ditës: Shqyrtimi i kërkesës së qytetarëve: z.Ismet Ahmeti, z.Zeqir Haxhija dhe z. Dervish Tahiri, për riurbanizimin e zonës së ngushtë në ngastrat kadastrale me numra: 700/10,701/2,704/1,705/1,705/2 dhe 701/1, si dhe dhënia e lejes së ndërtimit për objektin kolektiv të banimit me etazhitet B+P+8+NK në ngastrat kadastrale me numra: 700/10,701/2,704/1,705/1,dhe 705/2, me shumicën e votave e miratoi vendimin e qytetarëve të lartcekur për riurbanizimin e zonës dhe dhënien e lejes së ndërtimit.

Andaj, duke u bazuar në këtë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

CO:

- Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit,
- Parashtruesve të kërkesës,
- Drejtorisë për Administratë dhe Personel dhe
- Arkivës

Kryetari i Komunë

Dr.Pal Lekaj



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I KOMUNËS - GJAKOVË
SKUPŠTINA OPŠTINE DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



KOMUNA E GJAKOVËS

Kuvendi i Komunës

01 Nr. _____/2008

Datë 02.06.2008

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 02.06.2008, pas diskutimeve lidhur me pikat IV dhe V të rendit të ditës: Aprovimi i Projekt Rregullore Komunale mbi Plotësimin e Kushteve Minimale Higjiene Tekniko-Sanitare, Mbrojtjes në Punë si dhe Mbrojtjes së Mjedisit për nga Aspekti i Hapësirave Punuese si dhe stabilimenteve dhe pajisjeve si dhe Aprovimi i Projekt Rregullore për Lejen e Punës me Pije Alkoolike, e miratoi këtë:

V E N D I M

I. Formohet Komisioni për hartimin dhe plotësimin e këtyre dy Rregulloreve, në këtë përbërje:

1. Ruzhdi Këpuska,
2. Leonora Rraci,
3. Shqipe Kusari,
4. Arbër Sadiku,
5. Behxhet Shala dhe
6. Nazmi Juniku.

II. Kryesuesi i këtij Komisioni caktohet me marrëveshjen e vetë anëtarëve

III. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 02.06.2008, të cilën e kryesoi Kryetari i Komunës dr.Pal Lekaj, pas diskutimeve lidhur me pikën e IV dhe V të rendit të ditës: Aprovimi i Projekt Rregullore Komunale mbi Plotësimin e Kushteve Minimale Higjiene Tekniko – Sanitare, Mbrojtjes në Punë si dhe Mbrojtjes së Mjedisit për nga Aspekti i Hapësirave Punuese si dhe Stabilimenteve dhe Pajisjeve si dhe Aprovimi i Projekt Rregullore për Lejen e Punës me Pije Alkoolike, unanimisht e miratoi formimin e këtij Komisioni të cekur si në pikën e I – re, të këtij vendimi.

Duke u bazuar në theksimet e lartpërmendura, u vendos si në diapozitiv të këtij vendimi.

CO: Anëtarëve të Komisionit,
Drejtorisë për Punë Inspektuese,
Drejtorisë së Administratës dhe Personelit
Arkivës

Kryetari i Komunës,

Dr. Pal Lekaj



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I KOMUNËS - GJAKOVË
SKUPŠTINA OPŠTINE DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



KOMUNA E GJAKOVËS

Kuvendi i Komunës

01 Nr. _____/2008

Datë 02.06.2008

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 02.06.2008, pas diskutimit lidhur me pikën e VIII- të të rendit të ditës: Propozimi i formimit të Komisionit për emërimin e shesheve, rrugëve dhe rrugicave, e miratoi këtë:

V E N D I M

I. Formohet Komisioni për emërimin e shesheve, rrugëve dhe rrugicave, në këtë përbërje:

1. Nikollë Lleshi,
2. Gazmend Hoxha,
3. Mahmud Lila,
4. Simon Deda,
5. Fllanza Rexhepi,
6. Sejdi Sejdiu,
7. Masar Rizvanolli – përfaqësues i Shoqatës së Intelektualëve “ Jakova”,
8. Përfaqësuesi i Bashkësisë Islame,
9. Përfaqësuesi i Bashkësisë Katolike,
10. Kamber Kamberi,
11. Albert Lila – përfaqësues i Shoqërisë Civile dhe
12. Beqir Bytyqi – përfaqësues i komunitetit minoritarë RAE.

II. Kryesuesi i këtij Komisioni caktohet me marrëveshjen e vet anëtarëve.

III. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë.

A r s y e t i m

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në mbledhjen e mbajtur me datë,02.06.2008, të cilën e kryesoi Kryetari i Komunës dr.Pal Lekaj, pas diskutimeve lidhur me pikën e VIII-të, të rendit të ditës: Propozimi për formimin e Komisionit për emërimin e shesheve, rrugëve dhe rrugicave, unanimisht e miratoi formimin e këtij Komisioni të cekur si në pikën e I-re, të këtij vendimi.

Duke u bazuar në theksimet e lartpërmendura, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

CO: Anëtarëve të Komisionit,
Drejtorisë së Administratës dhe Personelit dhe
Arkivës

Kryetari i Komunës,

Dr. Pal Lekaj



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I KOMUNËS - GJAKOVË
SKUPŠTINA OPŠTINE DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 02.06.2008, pas diskutimit lidhur me pikën e VI- të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit të Buxhetit Komunal për periudhën janar – dhjetor 2007, e miratoi këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet Raporti i Buxhetit Komunal për periudhën janar – dhjetor 2007

KOMUNA E GJAKOVËS

Kuvendi i Komunës

01 Nr. _____/2008, dt.02.06.2008

CO: Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim,
Drejtorisë së Administratës dhe Personelit dhe
Arkivës

Kryetari i Komunës,

Dr. Pal Lekaj



KOMUNA E GJAKOVËS

Kuvendi i Komunës

01 Nr. _____/2008

Datë 02.06.2008

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 02.06.2008, pas diskutimit lidhur me pikën e VI- të të rendit të ditës: Shqyrtimi i kërkesës së DPUKM, për marrjen e Vendimit për Aproximin e Planit Rregullues Urban të potezit “ Dardania Perëndimore”, përgjatë rrugës Gjakovë – Pejë, ana perëndimore e miratoi këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet kërkesa e DPUKM-ës për marrjen e Vendimit të Planit Rregullues Urban të potezit “Dardania Perëndimore”, përgjatë rrugës Gjakovë – Pejë, ana perëndimore.

II. Obligohet Distribicioni i KEK-ut në Gjakovë, që në afatin sa më të shkurtër kohorë të bënë dislokimin e rrjetit ajror të tensionit të lartë nga “ Dardania Perëndimore”, pasi që pengon në realizimin e Projektit Rregullues Urban të këtij kompleksi.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

A r s y e t i m

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në mbledhjen e mbajtur me datë,02.06.2008, të cilën e kryesoi Kryetari i Komunës dr.Pal Lekaj, pas diskutimeve lidhur me pikën e VI-të, të rendit të ditës: Shqyrtimi i kërkesës së DPUKM-ës, për marrjen e Vendimit për Aproximin e Planit Rregullues Urban të potezit “ Dardania Perëndimore”, përgjatë rrugës Gjakovë – Pejë, ana perëndimore, unanimisht e miratoi vendimin e Planit Rregullues Urban të potezit “Dardania Perëndimore”, përgjatë rrugës Gjakovë – Pejë, ana perëndimore si dhe e autorizoi Distribicionin e KEK-ut në Gjakovë, që të bënë dislokimin e rrjetit ajror të tensionit të lartë nga “ Dardania Perëndimore”, në mënyrë që të bëhet realizimi i këtij Projekti.

Duke u bazuar në theksimet e lartpërmendura, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

CO: Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit,
Distribucionit të KEK-ut, në Gjakovë,
Drejtorisë së Administratës dhe Personelit dhe
Arkivës

Kryetari i Komunës,

Dr. Pal Lekaj